

INVESTIME 2023

Shpenzime nga Buxheti i Shtetit :

Ky fond eshte i ndare ne :

1- **Rikonstruksion i Terminalit Te pasagjereve**

Ky investim ka filluar gjate vitit 2022 dhe aktualisht pritet te fillojne punimet. Eshte nje investim nga Buxheti i Shtetit i shtrire ne dy vite dhe i ndare ne dy lote. Ne perfundim te ketij investimi Terminali i Pasagjereve do ti jete nenshtruar nje rehabilitimi total persa i perket komoditetit dhe sigurise ne perpunimin e pasagjereve . Duhet theksuar se i pothuajse i gjithë numri i pasagjereve dhe turistëve që hyjne dhe dalin ne port e bejne kete nepermjet Terminalit duke e bere me te amortizueshem ne aspekt kohor se cdo aset tjetër i Portit Detar Sarande

2- **Ndertimi i Hyrjes ne Portin Detar Sarande**

Vete terreni dhe infrastruktura rrugore e portit e ben te veshtire perballimin e punes ne hyrje-daljen e automjeteve nga porti sidomos gjate fluksit turistik pasi behen te dyja ne te njejtin ambient. Gjithashtu kushtet e punes se punonjesve te Forces se Sigurise dhe Biletaprereseve jene tejet te veshtira pasi punojne nen diell gjate veres dhe ne shi gjate dimrit. Ndertimi i Hyrjes se Port Detar Sarande do te fokusohet ne mbulimin e ketyre ambienteve, rritjen e sigurise nepermjet barrierave dhe trareve elektrike, pajisjen me sisteme elektronike te prerjes se biletave , sistemimin e infrastruktures rrugore per hyrje daljen e makinave, etj

3- **Ndertimi i Godines se Faciliteteve dhe Sherbimeve Portuale.**

Godina e Faciliteteve eshte nje godine qe do te ndertohet ne ambientet e portit aty ku aktualisht eshte parkimi i automjeteve . Do te sherbej per ndertimin e zyrave te cilat do te perdoren kryesisht per dhenie me qera per agjensite turistike te cilat operojne ne portin tone,per qiradhenie per institucioneve shteterore te cilat po ashtu operojne ne port ,etj. Disa nga keto ambiente do te jene edhe ne shfrytezim te shoqerise si zyra , ambiente per sistemin e vezhgimit, etj. Do te ndertohet nje ambient sherbimi modern ne funksion te turistëve kryesisht ata te cilet e frekuentojne portin me jahtet e tyre por edhe turistëve e pasagjereve te cilet jane ne pritje te orareve te levizjes se linjave te trageteve.

4.2 Investimeve nga fondet e vete shoqerise

1- Rikualifikim Ambienteve te Jashme te Portit

Ambientet e Jashme te portit jane asete te ndertuara ne vitin 2012 dhe qe prej asaj kohe per arsye te planifikimit jo te mire , ndikimi korrosiv i detit , rritja ne disa fish e volumit te punes e kane bere te domosdoshme nderhyrjen per riparim dhe riplanifikim i perdorimit te ketyre ambienteve . Keto nderhyrje do te behen si per arsye te funksionalitetit por edhe te komoditetit dhe estetikes qe jane te domosdoshme per nje port qe perpunon pasagjere dhe turiste.

Do te behet nderhyrje ne :

-Riveshje me tapet asfaltobetoni i kalates Kruiser

Kjo nderhyrje do te behet per te eliminuar disnivelet dhe carjet e shtreses te asfaltit. Keto sjellin edhe mbajtjen e ujit ne pellgje ne rast shiu apo kur ne aplikojme larjen e kalates. Eshte nje ambient qe perdoret edhe nga kruazierat per aktivitete qe ato zhvillojne te toke me turistet dhe estetika eshte mese e nevojshme.

-Sistemim dhe asfaltim i siperfaqes 800 m2 te shatervani

Ky eshte nje terren i shtruar me pllaka betoni te cilat pavarsisht se ne mundohemi gjate gjithë kohes ta mbajme ne gjendje te mire pune levizjet dhe spostimet e tyre nga kalimi i automjeteve e bejne te veshtire kalimin e kembesoreve .

-Sistemim i lulishtes nr 1

Eshte lulishtja e cila ndodhet ne pjesen e Zones se Kufizuar . Rreth kesaj lulishte do te ndertohet nje bordure rrethuese edhe per qellim estetik por edhe per perdorjen e kesaj bordure per tu ulur nga pasagjeret dhe turistet gjate momenteve te imbarkimit dhe disembarkimit.

-Krijimi i hapësirave per parkim ne kalaten e madhe.

Eshte pare e nevojshme zgjerimi i siperfaqeve per parkim ne funksion te fluksit turistik. Heqja e disa prej trotuareve te panevojshem ne kalaten e madhe do te krijoje hapsira te bollshme dhe te nevojshme ne perdorim te portit per parkim.

-Sistemim i siperfaqes prej 324 m2 i trotuarit qe ndan dy kalatat

Eshte nje ndarje midis kalates Roro dhe kalates Kruizer e panevojshme e cila me pare ka funksionuar si ndarje me Zonen e Kufizuar . Tani qe eshte percaktuar dhe ndare me gardh metalik kjo zone kjo ndarje eshte e panevojshme dhe penguese per levizjen e autobuzeve ne ambientet e portit.

-Rrethim i jashtem me profile hekuri ne pjesen jugore te portit.

Behet fjale per gardhin rrethues ne pjesen jugore te portit. Korrozioni nga kripa e detit e ka kalbur nje pjese te madhe te ketij gardhi metalik. Do te behet zevendesimi i tij po me profile metalike dhe nme perforcim te metejshe me efekt rritjen e sigurise ne port . Eshte edhe nje kerkese e vazhdueshme e organeve qendrore te cilat jane pergjegjese per sigurine ne porte dhe aeroporte per riparimin e ketij sektori te gardhit rrethues.

Te gjitha keto nderhyrje do te kene efekt ne rritjen e siperfaqes se perdorshme per parkim, ne rritjen e sigurise portuale , ne rritjen e komoditetit te perpunimit te turisteve ne kalate dhe pikat e imbarkim-disbarkimit,etj .

Te gjitha keto procese do ti nenshtrohen prokurimit hap pas hapi.

-Panele te reja elektrike ne kalaten RoRo dhe ne kalaten e kruizeve, sepse ato aktualet jane amortizuar mjaftueshem nga lageshtia e detit dhe perbejne rrezik perdorimi. Si dhe, parametrat e kerkuara nga agjensite e jahteve nuk permbushen nga panelet aktuale.

-Portat me sistem automatik digital, nenkupton portat e hyrjes ne zonen e sigurise, per te cilat akses ka Policia dhe Siguria Portuale. Keto porta, edhe me kerkesen e agjensive dhe me kerkesen e vet punonjesve, ne periudhe fluksi, duhet domosdoshmerisht te jene automatike.

2- Certifikimi me ISO 9001:2015, ISO 37001:2016, ISO 14001:2015 dhe ISO 27001:2013

Porti Detar Sarande sh.a. në përputhje me qëllimet e saj strategjike, si edhe me kërkesat e organizmave përgjegjës kombëtare dhe ndërkombëtarë përmes projektit të shërbimit të konsulencës do te realizoje certifikimin kundrejt standardeve ISO 9001:2015, ISO 37001:2016, ISO 14001:2015 dhe ISO 27001:2013. Në këtë fazë do të ndërtohet i gjithë seti i duhur dokumentar në përputhje me kërkesat e standardeve ISO më sipër. Do të krijohet Njësia e Cilësisë dhe Standardeve për të mbështetur implementimin e dokumentacionit, ndërgjegjësimin e stafit në mënyrë të tillë që të plotësohen në vazhdimësi kërkesat minimale të certifikimit, e më pas të vijohet me përmirësimin e vazhdueshëm dhe arritjen e ekselencës në operacionet.

Ne vijim dhe te VKM Nr. 761, date 12.12.2022 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritiketë informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit Porti Detar Sarande sh.a.

është identifikuar si institucion me infrastrukture kritike për Sistemin e bazës së të dhënave për trafikun detar dhe sistemin Key Station.

Institucioni kërkon tashmë të vijojë angazhimin lidhur me standardet ISO përmes suportit nga një organizatë konsulente e fushës për hapat në vijim:

- **Ndërtimin e sistemeve përkatëse sipas standarteve ISO.** Ai do të ketë nevojë për përmirësime, ndryshime dhe përfshirje edhe më të madhe të dokumentacionit operacional. Konsulentët përmes trajnimeve specifike për standardet ISO do të rrisin kualifikimin e ekipit të menaxhimit të standardeve duke siguruar për ta kualifikime të rangut evropian për t'i aftësuar ata në trajtimin e problematikave thënë sa më sipër. Po kështu përmes auditeve të brendshme konsulentët do të identifikojnë periodikisht mangësitë dhe koeperojnë me institucionin për dhënien e zgjidhjeve të duhura me qëllim që t'i paraprihet auditeve certifikuese nga trupa certifikuese, në mënyrë që ato të kalohen çdo një vit me sukses, e duke mos humbur kështu të drejtën e mbajtjes së certifikatave përkatëse.

- **Përdorimi dhe përmirësimi i Sistemeve të Menaxhimit** bazuar në kërkesat e 4 standarteve bazë ISO që përdor sot çdo organizatë e suksesshme (ISO 9001, ISO14001, ISO 37001, ISO 27001) do të luajnë rol edhe në mirëfunksionimin e institucionit. Kështu që garantimi i certifikimeve ndërkombëtare ISO është themelor për të patur të palëkundur besimin e përdoruesve turistë dhe jo vetëm. Konsulentët do të duhet të ofrojnë po ashtu trajnime për fuqizimin e punonjësve të institucionit për tema të lidhura me Menaxhimin portual, të Operacioneve dhe sigurisë në punë të Terminaleve, si dhe të japin ekspertizë për menaxhimin e zhvillimit të vazhdueshëm dhe të aktivitete të tjera të Zhvillimit portual.

- **Ekipi i menaxhimit të standardeve do të përballet në vijim edhe me rritjen e përgjegjësisë për të audituar edhe kontraktorët apo koncesionarët e institucionit** lidhur me çeshtje të menaxhimit të cilësisë, mjedisit, sigurisë në punë apo sigurisë së informacionit. Institucioni duhet të jetë vetë e certifikuar në vijimësi me standardet ISO dhe po ashtu në anën tjetër do të duhet të ketë një nivel gjithmonë e më të lartë profesional gjatë auditeve që do të zhvillojë për kontraktorët dhe koncesionarët. Ky nivel i lartë do mund të garantohet përmes kualifikimeve profesionale/ trajnimeve që do ofrohen nga organizata konsulente e përzgjedhur nga institucioni. Keto kualifikime dhe certifikime do të rishikohen çdo vit sipas formulës së standarteve ISO në vijimësi për t'u ndjekur në objektivat e institucionit.

Afati I vlefshem per keto certifikime eshte 3 vjet (36 muaj)

3-Krijim i kapaciteteve kibernetike dhe digjitalizimi i sherbimeve te ofruara ndaj vizitoreve

Qellimi i ketij investimi eshte modernizimi i strukturave informatike te Portit te Sarandes nepermjet zhvillimit te 2 software-ve te dedikuar per ofrimin e nje sherbimi cilesor, bashkekohore dhe te sigurt per vizitoret e Portit (udhetare, turiste) te cilet jane gjithnje e me te medhenj ne numer nga viti ne vit si edhe per vete Portin e Sarandes si nje strukture e rendesie te vecante.

Projekti konsiston ne realizimin e :

- **Sigurise Kibernetike nepermjet proceseve te Auditimit dhe Riskasestment**
- **PentTest per certifikimin e sigurise Kibernetike**
- **Keshillimit dhe realizimit te infrastruktures perkates - Zhvillimi i politikave te Sigurise Kibernetike**
- **Ndergjegjesimi i punonjesve nepermjet Trajnimit te personelit**
- **Sugjerime per permiresimin e infrastruktures dhe politikave**
- **Audit i te gjithe struktures dhe sigurise Kibernetike**
- **Ndertimin e nje infopoint digjital ne hyrje te portit**
- **Realizimin e Software per informacionin e nevojshem mbi Oraret nisjes dhe mberritjes se Trageteve**

Porti Detar Sarande ne perfundim te ketij investimi do te kete nje sistem te forte te mbrojtjes nga harerimet duke ju pergjigjur situatave aktuale por do te rrise dhenien e informacionit te nevojshem per turiste dhe pasagjere nepermjet dy pikave elektronike te informimit . Ne disponojme aktualisht dhe projektin per realizimin e ketij investimi.

Investime 2024

Shpenzime nga Buxheti i Shtetit

Per vitin 2024 kemi te parashikuar nga Buxheti i Shtetit **0 lek** .

Investimeve nga fondet e vete shoqerise

- 1.** Projekt per ndertimin e shteses se Terminalit te Udhetareve
- 2.** Projekt per ndertimin e Objektivit te Sherbimeve
- 3.** Projekt per ndertimin e Bovave statike ne te cilat lidhen krocierat e permasave te medha
- 4.** Investim per vendosjen e stacionit per karikimin e makinave elektrike
- 5.** Investim per automatizimin e portave hyrese ne zonen e kufizuar te kontrollit
- 6.** Investim per sigurine Kibernetike dhe plotesimin e kriterëve te AKCESK
- 7.** Investim per mbulimin me kamera te territorit dhe instalimin e serverit dhe DVR-ve te pershtatshme per kete sistem
- 8.** Investim per permiresimin e Interiorit te Terminalit te Udhetareve
- 9.** Investim per rikonstruksionin e gropes septike dhe lidhjen me rrjetin e kanalizimeve te qytetit
- 10.** Investim per interior te salles se mbledhjeve dhe zyren e administratorit

